



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA PËR PROCESET E BIZNESIT

Nr. 21870 / Prot.

Tiranë, më 8/3/2022

Lënda: Kthim përgjigje.

**DHOMËS AMERIKANE TË TREGËTISË**  
*Rruga Ibrahim Rugova, SKY TOWER, Suita 11 - 3, Tirana*

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 32 Prot, datë 7.12.2021, protokolluar me tonën me Nr. 21870 Prot, datë 07.12.2021, në lidhje me kërkesën tuaj mbi ndryshimet ligjore dhe problematikave të hasura të fiskalizimit, ju informojmë si më poshtë vijon:

Duke marrë në konsideratë propozimet e DhAT, por edhe të gjithë grupeve të interesit, në dhjetor 2021 janë miratuar ndryshimet emergjente të lidhura me procesin e fiskalizimin të konkluduara me:

- Akt normativ nr. 36, datë 24.12.2021 për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar
- Udhëzim nr. 27, datë 31.12.2021 për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 16, datë 3.4.2020, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"

Ndryshimet si më sipër zgjidhin problematikat e parashtruara edhe nga DhAT në përgjithësi dhe konkretisht problematikat lidhur me pranimin e faturave utilitare, shtyrjen e afatit të raportimit të librave si dhe shtyrjen e afatit të penaliteteve për disa kategori specifike.

Këto ndryshime janë shoqëruar edhe me njoftime/publikime sqaruese në faqen zyrtare të internetit të Administratës Tatimore.

Në fokus të propozimeve dhe ndryshimeve kanë qenë problematikat emergjente dhe të domosdoshme për ndryshim, ndërkohë që po trajtohen të gjitha problematikat e tjera të shfaqura më parë apo edhe të tjera në vijim, përgjatë përditshmërisë së procesit.

Megjithatë, më poshtë po sqarojmë disa problematika për platformën qendrore të faturave të adresuara nga ana juaj, të cilat mund të jenë zgjidhur apo që janë në proces.

- *Lëshimi i faturave korriguese për periudhat përpresa hyrjes në fuqi të ligjit përfiskalizimin.*

Ky funksionalitet është në zhvillim e sipër nga ana jonë, ku tatimpaguesit do të kenë mundësinë e vendosjes së numrit serial të faturës së lëshuar përpara fiskalizimit, si referenced për faturën korriguese, dhe jemi në fazën e testimeve përfundimtare. Sapo ky zhvillim të jetë funksional, do të njoftoheni me anë të një njoftimi në faqen zyrtare te interentit të Administratës Tatimore.

Sjellim në vëmendje se, deri në periudhën tatimore Qershori 2022, deklarimi i librave të shitjes e blerjes dhe deklaratës së TVSH-së do të vijojë të kryhet manualisht, përmes llogarisë së tatimpaguesit në E-filing.

- *Problematika funksionale të Platformës qendrore të faturave – SelfCare (Probleme në aksesimin e menuve në përgjithësi, Sharkimi i faturave nga SelfCare, Mungesa e faturave).*

Këto problematika janë shfaqur kryesisht për shkak të ngarkesës së përdorimit të portalit, por janë marrë masat e nevojshme, për të përmirësuar performancën e sistemit, duke rritur kapacitetet si nga ana hardware, ashtu edhe software.

- *Fatura të dyfishuara: Në librat e blerjeve dhe të shitjeve janë hasur raste kur e njëjtë faturë është shfaqur më shumë se një herë.*

Lidhur me dublikimin apo shfaqjen më shumë se një herë të faturave të fiskalizuara, po merren masa nga ana teknike, në bashkëpunim me kompanitë e certifikuara për zgjidhje software-ike, për të eliminuar këtë fenomen.

- *Mosreflektim i pagesave të e-faturave: Në disa raste e-faturat e paguara nga e njëjtë bankë reflektohen si të paguara në platformë, ndërsa në disa raste të tjera jo.*

Me qëllim verifikimin dhe zgjidhjen e kësaj problematike, lutemi na referoni një rast konkret, pasi mund të rezultojë që banka ende mund të mos ketë raportuar pagesat e këtyre faturave, apo faturat nuk janë fatura elektronike, dhe si të tilla bankat nuk kanë detyrim ligjor për të raportuar pagesën e tyre.

- *Të dhëna jo konsistente. Formati i reverse-charge.*

Me qëllim analizimin dhe zgjidhjen e këtyre problematikave, lutemi na referoni raste konkrete (kopje faturash në PDF, NIPT, NIVF, NSLF etj).

- *Exporti i librave të blerjes dhe shitjes.*

Me zhvillimet e fundit të kryera për përmirësimin e portalit SelfCare, tatimpaguesit mund të eksportojnë deri në 65000 rreshta në formatin Excel. Shfaqja e faturave në portal mund të bëhet deri në 25 rreshta për faqe. Gjithashtu, nga pala mirëmbajtëse po analizohet mundësia e eksportimit të të dhënavës në formatin CSV, i cili jep mundësinë e eksportimit të të dhënavës në më shumë rreshta sesa formati Excel.

- *Fiskalizimi i importeve.*

Lidhur me fiskalizimin e importeve, po kryhen zhvillime në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për përmirësimin dhe eliminimin e të gjitha problematikave që tatimpaguesit kanë hasur gjatë fiskalizimit të importeve.

- *Faturat me gabime, Proceset e e-faturës, Lloji i e-faturës, Mënyrat e pagesave.*

Manuali i përdorimit të portalit SelfCare është në përditësim e sipër, ku krahas shpjegimeve të llojeve të proceseve të faturimit elektronik apo mënyrës së pagesës, do të përfshihen edhe përmirësimet e bëra dhe zhvillimet e reja që janë kryer deri tani. Manuali i përditësuar do të publikohet në faqen zyrtare. Gjithashtu, po punohet për përditësimin e listës së kodeve të gabimeve, me shpjegimet dhe sqarimet përkatëse për veprimet konkrete që duhet të kryejnë tatimpaguesit për zgjidhjen e tyre..

- *Operatoret nuk mund të regjistrohen në Platformën Qendrore të Faturave nëse ju ka skaduar letërnjoftimi (karta e identitetit) apo nëse janë shtetas të huaj të deklaruar në listëpagesë por që nuk janë në regjistrin e gjendjes civile. Një problematike tjeter është se nuk është e qarte se si ndryshohen datat efektive të aksesit të operatoreve pasi ikonat në platforme nuk lejojnë modifikimin*

Shtimi i operatorëve, kryhet nëpërmjet numrit personal të identifikimit (ID) të punonjësit që figuron i punësuar në subjektin përkatës dhe jo nëpërmjet numrit të dokumentit. Për të kryer një regjistrim të suksesshëm, është e nevojshme vendosja në mënyrë korrekte e numrit të identifikimit të regjistruar në listëpagesë apo në Formularin e të punësuarve rishtazi (ESIG 027), për punonjësin shtetas shqiptar apo të huaj.

Administrata Tatimore mbetet e hapur dhe inkurajon çdo sugjerim apo mendim lidhur me përmirësimet apo zhvillimet e reja që kanë të bëjnë me procesin e fiskalizimit, pasi në fokusin e saj është që ky proces jetik të mund të përbushë qëllimin për të cilin është ngritur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ceno KLOSI**

